



Letër për prindër nr. 1

17.03.2020

Ndalesa e hyrjes dhe përkujdesjes së fëmijëve për persona kyç

MKFFI dëshiron që t'ju informojë prindërit sa më mirë në ditët dhe javët në vijim. Ne do t'ju aktualizojmë informacionet vazhdimisht në faqen tonë të internetit (www.mkffi.nrw). Pos asaj ne do të botojmë letra për prindër, me të cilat ne do t'ju informojmë ju për çështje të ndryshme.

Me këtë letër të parë për prindër ne dëshirojmë t'ju falënderojmë para së gjithash për mirëkuptimin e plotë sipas pikëpamjes sonë, që ata kanë treguar në zbatimin e kësaj urdhëresë për ndalimin e kontakteve. Prindërit kanë ndihmuar në masë të madhe në ditën e djeshme, që personat kyç të cilët janë të pazëvendësueshëm në këtë situatë aktuale kanë mundur që të kenë përkujdesje të fëmijëve dhe ndihmuar në të njëjtën kohë në marrjen e masave për ngadalësimin e pandemisë. Këtu kanë bërë familjet e Landit Nordrhein-Westfalen një punë të shkëlqyeshme. Ne na është e qartë: familjet në Landin e Nordrhein-Westfalen ndodhen në një presion të lartë. Ata qëndrojnë para sfidave të mëdha në lidhje me përkujdesjen e fëmijëve. Kjo sjell për shumë prindër pyetje shumë të vështira, madje për disa prindër edhe pyetje egzistenciale. Ne ju lusim për mirëkuptim, që ne jemi fokusuar ditëve të fundit në realizimin e ndalesës së hyrjes dhe në sigurimin e përkujdesjes për fëmijët e prindëreve kyç. Ne mund t'ju sigurojmë, që: ne do të sqarojmë pyetjet tjera sa më shpejt, që është e mundur.



Ju lutem organizoni përkujdesjen me përgjegjësi të plotë dhe duke marrë parasysh rekomandimet e Institutit Robert-Koch. Ju lutem mos i leni fëmijët për përkujdesje tek gjyshet/gjyshët e tyre.

Ministria për Fëmijë, Familje, Refugjat dhe Integrim i Landit Nordrhein-Westfalen